



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2021:107929

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06055054

P.nr.221/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurve E.D. nga fshati ..., komuna Vushtrri dhe E.Z., nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.435/2021 të datës 02.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik të datës 17.07.2024, në praninë e prokurorit të shtetit dhe të pandehurve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. E.D. nga i ati S..., e ëma F..., e gjinisë A..., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", nr. ..., komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i vetëpunësuar, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

II. E.Z. nga i ati N..., e ëma G..., e gjinisë I..., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike.

JANË FAJTORE

SEPSE: Me datë 19.02.2021, rreth orës 01:30, në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, si bashkëkryes, pas një marrëveshje paraprake, me qëllim që vetes ti sjellin përfitim pasurorë, ata vodhën pasurinë e luajtshme të personit tjetër, në atë mënyrë që gjatë natës nga oborri i shtëpisë familjare të të dëmtuarit A.S., morën traktorin e tipit "Ferguson" IMT 539, ngjyrë e kuqe, të cilin policia pas hetimeve të kryera e gjeti në parkingun e ndërtesës "Diari".

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Andaj gjykata, duke u bazuar ne dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 31, 38, 40, 42, 43, 69, 70 dhe nenit 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, si dhe nenit 364, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së:

## GJYKON

I. Të pandehurit të parë E.D. i shqipton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, dënimi me gjobë do të i'u zëvendësohet në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë burgim llogaritet barabartë me 20 (njëzet) euro gjobë.

Po ashtu, kumulativisht i shqipton edhe DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të pandehurit të dytë E.Z. i shqipton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, dënimi me gjobë do të i'u zëvendësohet në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë burgim llogaritet barabartë me 20 (njëzet) euro gjobë.

Po ashtu, kumulativisht i shqipton edhe DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar A.S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzime procedurale të paguajnë: në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në emër të transportit të të pandehurve, nga qendrat ku ata janë në vuajtje të dënimit, secili veç e veç shumën prej 60 (gjashtëdhjetë) euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 20 (njëzet) euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.435/2021 të datës 02.06.2021, ndaj të pandehurve E.D. nga fshati ..., komuna Vushtrri dhe E.Z., nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak te veprës penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, në të cilën aktakuzë, prokurori i shtetit ka kërkuar nga gjykata që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të pandehurit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 17.07.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri E.D. dhe i pandehuri E.Z., të cilët janë pjesë përmes njësitit për transportin e të burgosurve, nga Qendra Korrektuese në Dubravë.

#### *Deklarimet e të pandehurve lidhur me fajësinë*

Gjyqtari i vetëm gjykues i ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tyre dhe pasi që gjykata është bindur se të pandehurit i kanë kuptuar udhëzimet e gjykatës, pas leximit të aktakuzës, u është dhënë mundësia që të deklarojnë lidhur me pranimin ose jo të fajësisë.

I pandehuri i parë E.D. ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka bërë, i dëmtuari ka vizituar familjen e të pandehurit dhe u ka thënë se nuk kërkon kompensim, por që e di se ka gabuar, traktori i është kthyer të dëmtuarit, dhe i ka kërkuar falje dhe prapë i kërkon falje, pasi që e janë fqinjë dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të kësaj natyre apo çfarëdo natyre tjetër.

I pandehuri i dytë E.Z. ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i vjen keq për atë se çka ka ndodh, nuk e kanë ditë se i kujt është traktori, kanë menduar se është i një serbi, dhe nëse është nevoja mund të ia kompensojnë dëmin të dëmtuarit. Gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe të mos përsërisë vepra penale të kësaj natyre, si dhe ka shprehur gatishmëri që të dëmtuarit t'i kërkojë falje dhe ka shtuar se sikur ta kishte ditë se është traktori i tij, për shkak të raporteve fqinjësore nuk do ta kishte bërë atë që ka bërë.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të pandehurit ti shpallë fajtorë dhe ti dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese edhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, kërkim faljen nga ana e tyre, gatishmërinë që nëse e nevojshme të ia kompensojnë dëmin të dëmtuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes në drejtim të kryerjes së veprës penale, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale për të pandehurit E.D. dhe E.Z. dhe nëse nga ajo rezulton se të pandehurit janë të dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-BD-129, i datës 19.02.2021; procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit A.S., i datës 19.02.2021; raporti i oficerit i datës 19.02.2021; vërtetimi mbi kthimin e sendeve të gjetura, i datës 19.02.2021; procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit E.D., i datës 24.02.2021; procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit E.Z., i datës 24.02.2024; foto dokumentacioni në 16 shtojca si dhe të dhënat e të pandehurve nga data baza e Policisë së Kosovës.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në deklarinimin e vetë të pandehurve, ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se të pandehurit E.D. dhe E.Z. me dashje, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 313 par.1 të KPRK – së është parashikuar se veprën penale *Vjedhja* e kryen: “*Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*”, elemente këto të figurës së kësaj vepre penale që janë përmbushur tërësisht në këtë çështje penale, pasi që si nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, e gjithashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve vërtetohet se të pandehurit kanë marrë pasurinë e luajtshme të të dëmtuarit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të saj.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është në përputhje me të gjitha provat në shkresat e lëndës, gjykata ka vendosur që të pandehurit t’i shpallë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohen, ngase veprimet e tyre përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale me të cilën ngarkohen dhe se për të njëjtat janë penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit, bazuar në nenin 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është e sanksionuar me dënim me gjobë dhe burgim deri në tri (3) vite.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69 dhe 70 të KPRK-së, sa i përket të pandehurit të parë E.D. ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur nga i pandehuri si dhe

zotimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale si dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Ndërsa për të pandehurin e dytë E.Z., gjykata si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që të mos kryejë vepra penale, dhe gatishmërinë e shprehur për të kompensuar dëmin ndaj të dëmtuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që të pandehurit në të ardhmen të kenë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjithashtu duke pasur parasysh pendimin e shprehur nga të pandehurit dhe të gjitha rrethanat tjera lehtësuese, gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur vend që të pandehurve t'u shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë, dhe se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e kryerjes së veprës, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e morri në bazë të nenit 462 të KPPRK-së, i cili parasheh se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 në lidhje me nenin 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr. 221/2021, datë 15.08.2024

Zyrtarja ligjore  
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.